



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 79 Prot.

Tiranë, më datë 02.02.2022

VENDIM
Nr. 21, datë 02.02.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.02.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektit kërkimor shkencor të ri “Aplikimi i disa teknikave analitike për studimin e ikonës së mbipikturuar “Shën Maria me shenjtorë” (Nr. In. 3622), pjesë e Fondit të Muzeut të Artit Mesjetar Korçë”, kërkesë e znj. Flora Marolli në kuadër të mbrojtjes së temës së diplomës të studimeve pasuniversitare në Universitetin “Aristoteli” të Selanikut;
2. Procesi i kampionmarrjes të kryhet nën mbikëqyrjen e specialistëve të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë;
3. Të depozitohet pranë IKTK-së kopje e rezultateve të studimit dhe analizave në kuadër të këtij projekti kërkimor shkencor;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

